



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 6644/1 prot.

Tiranë, 29. 12. 2020

U R D H Ë R

Nr. 20, datë 29.12.2020

PËR

**MARRJEN E MASAVE DHE MONITORIMIN E VEPRIMTARISË,
SJELLJES APO PËRDORIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE,
FINANCIARE DHE LOGJISTIKE TË KRYEMINISTRISË GJATË
PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET NË KUVENDIN
E SHQIPËRISË, PËR VITIN 2021**

Në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të vendimit nr.9, datë 24.12.2020, "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve", të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

U R D H Ë R O J:

1. Përcaktimin e znj. Irsida Komici, me detyrë koordinatore pranë zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrisë, si person kontakti për koordinimin e raportimit të Këshillit të Ministrave dhe Kryeministrisë, përfshirë institucionet e varësisë, të cilat nuk raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në KQZ.
2. Me qëllim përmbushjen e detyrimit të Kryeministrit, sipas parashikimit të vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të KQZ-së, kabineti i Kryeministrit të dërgojë pranë zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm informacionin e plotë për zhvillimin e veprimtarive dhe aktiviteteve të Kryeministrit 7 (shtatë) ditë përpara datës

së planifikuar për zhvillimin e tyre. Raportimi të kryhet sipas formatit të hartuar nga KQZ-ja dhe, në çdo rast, në përputhje me rregullat e sigurisë dhe protokollit në lidhje me lëvizjet e Kryeministrit.

3. Me qëllim përmbushjen e detyrimit të Zëvendëskryeministrit e të ministrave të Shtetit, sipas parashikimit të vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të KQZ-së, drejtorët e kabineteve të Zëvendëskryeministrit, ministrit të Shtetit për Diasporën, ministrit të Shtetit për Rindërtimin, ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Kryenegociatorit për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian të dërgojnë pranë personit të përcaktuar nga Zëvendëskryeministri, ministri i Shtetit për Diasporën, ministri i Shtetit për Rindërtimin, ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes e Kryenegociatori informacionin e plotë për zhvillimin e veprimtarive dhe aktivitetëve 7 (shtatë) ditë përpara datës së planifikuar për zhvillimin e tyre. Raportimi të kryhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në KQZ.
4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtori Ekzekutiv i Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve të Integruara të përcaktojnë personat e kontaktit për koordinimin e raportimit të secilit institucion në KQZ.
5. Raportimi në ndërfaqen e KQZ-së të kryhet nga personat e përcaktuar në pikat 1, 3 dhe 4, të këtij urdhri, jo më vonë se 5 (pesë) ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë ose të aktivitetit publik.
6. Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë dhe Njësia e Akteve Rregullatore të Ministrave të marrin masat për të mos shqyrtuar dhe për të mos i propozuar Sekretarit të Përgjithshëm për t'u përfshirë në rendin e ditës së mbledhjeve të Këshillit të Ministrave, për shqyrtim dhe miratim, aktet e përmendura në pikën 3, të vendimit nr.9, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
7. Departamenti i Administrimit, Transparencës dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, në bashkëpunim me drejtorët e departamenteve të Kryeministrit, është përgjegjës për:
 - a) kontrollin në mënyrë periodike të veprimtarisë së nëpunësve dhe punonjësve të Kryeministrit që ndjekin procesin e punës në ambientet e institucionit, përfshirë dhe ata që punojnë në distancë (*on-line*), me qëllim shmangien dhe parandalimin e nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e

- punonjësve të administratës shtetërore në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje;
- b) publikimin e të dhënave të kontaktit në faqen zyrtare të internetit, duke kërkuar denoncimin e çdo rasti të përfshirjes ose nxitjes apo kërkesës për përfshirjen e punonjësve të Kryeministrit në veprimtari politike apo në mbështetje të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje;
- c) verifikimin dhe analizimin e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me përdorimin e mjeteve, fondeve e materialeve të ndryshme, si dhe mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë institucionale, gjatë periudhës përpara fillimit dhe gjatë fushatës zgjedhore, në funksion të evidentimit të përdorimit ose jo të tyre për qëllime elektorale;
- ç) verifikimin që automjetet dhe karburanti të ndalohen të përdoren për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore ose të kandidatëve në zgjedhje;
- d) njoftimin e punonjësve të administratës për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore;
- dh) krijimin për vëzhguesit dhe shoqatat e regjistruara në KQZ, si vëzhgues të procesit zgjedhor, të aksesit të plotë për të marrë informacion në lidhje me detyrimet ligjore të administratës publike, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për informimin e publikut;
- e) marrjen e masave dhe realizimin e monitorimit të zbatimit të parashikimeve ligjore për të garantuar mospërdorimin e burimeve njerëzore të Kryeministrit në funksion të veprimtarisë së fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr.9131, datë 8.9.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", apo mospërdorimin e fondeve apo mjeteve dhe materialeve në inventar të Kryeministrit për veprimtari të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore.
8. Drejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e institucioneve të varësisë së Kryeministrit detyrohen të marrin masat përkatëse me qëllim zbatimin e vendimit nr.9, datë 24.12.2020, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe t'i raportojnë periodikisht zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministrit.
9. Ngarkohen subjektet e këtij urdhri të kryejnë detyrat e përcaktuara në këtë urdhër deri në datën 25 prill 2021.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ENGJELL AGAÇI



AGJENCISË SË AUDITIMIT TË PROGRAMEVE TË
ASISTENCËS TË AKREDITUARA NGA BASHKIMI
EVROPIAN
AGJENCISË SË KOORDINIMIT KUNDËR
EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM
AGJENCISË SË MENAXHIMIT TË BURIMEVE
UJORE
AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË
CIVILE
AGJENCISË TELEGRAFIKE SHQIPTARE
AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN
GJEOHAPËSINOR
AUTORITETIT KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN
ELEKTRONIK DHE SIGURINË KIBERNETIKE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



NR.PROT. 6644/1
DATË 29.12. 2020

DEPARTAMENTIT RREGULLATOR DHE TË
PËRPUTSHMËRISË
DEPARTAMENTIT TË ZHVILLIMIT DHE
MIRËQEVERISJES
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRIMIT,
TRANSPARENCËS DHE ANTIKORRUPSIONIT
NJËSISË SË POLITIKAVE PËR ZHVILLIM DHE
MIRËQEVERISJE
DREJTORISË SË POLITIKAVE DHE SISTEMIT PËR
MIRËQEVERISJE
DREJTORISË SË POLITIKAVE DHE PRIORITETEVE
PËR ZHVILLIMIT
NJËSISË SË PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT DHE
BASHKËPUNIMIT
NJËSISË SË PROJEKTEVE KOMBËTARE TË
ZHVILLIMIT
NJËSISË SË AKTEVE RREGULLATORE TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NJËSISË SË PROGRAMIMIT TË AKTEVE
RREGULLATORE DHE RIA
NJËSISË LIGJORE TË KOORDINIMIT TË NISMAVE
PRIORITARE DHE TË ACQUIS
NJËSISË SË TRANSPARENCËS DHE
ANTI-KORRUPSIONIT
NJËSISË SË BUXHETIT DHE ADMINBISTRIMIT
DREJTORISË SË ADMINISTRIMIT TË BRENDSHËM
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QE VERITARE
DREJTORISË SË SIGURIMIT TË INFORMACIONIT
TË KLASIFIKUAR
SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS
PUBLIKE
NJËSISË SPECIALE ANTIKORRUPSION DHE
ANTIEVAZION
AVOKATURËS SË SHTETIT
AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË
CIVILE
AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA
INSPEKTORATIT QENDROR
AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT
DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE